

Përmbledhje e  
**DISPOZITAVE**  
të Zekatit

---

---

FLAMUR KABASHI



Flamur Kabashi

**PËRMBLEDHJE**  
**E DISPOZITAVE TË ZEKATIT**

Mitrovicë, 2018

**Titulli: Përmbledhje e dispozitave të zekatit**

**Autor: Flamur Kabashi**

**Redaktor fetar: Dr. Muhamed Broja**

**Radaktor gjuhësor: Jeton Koqinaj**

**Radhitja kompjuterike: Afrim Radoniqi**

**Mitrovicë, Qershor - 2018**

## *Parathënie*

Falënderimi i takon Allahut të Madhëruar, i Cili e ka bërë të qartë rrugën e drejtë, e ka zbritur Kuranin, e ka dërguar Muhamedin ﷺ sqarues të tij, e ka bërë fenë të lehtë, e ka kompletuar dhe e ka ruajtur atë prej ndryshimeve. Dëshmoj se askush nuk meriton të adhurohet me të drejtë përveç Tij dhe dëshmoj se Muhamedi ﷺ është rob dhe i Dërguari i Tij.

Meqë jetojmë në një kohë kur një pjesë e madhe e praktikuesve të fesë dispozitat e zekatit i njohin vetëm përmes përgjigjeve të hoxhallarëve, e jo si rezultat që kanë lexuar diç rreth tij e as që e kanë mësuar si kapitull të fikhut, prej fillimit deri në mbarim, është shumë e nevojshme që, në mënyrë të thjeshtë e me shembuj bashkëkohorë, njohuritë rreth zekatit t’u servohen praktiuesve të fesë përmes një libri përmbledhës të dispozitave të zekatit.

Së këndejmi, vjen ky punim, përmes të cilit lexuesit do t’i ofrojë dispozitat e zekatit në formë përmbledhëse, duke u mbështetur në argumentet e Kuranit dhe Sunetit, përmes frymës së dijetarëve të hershëm dhe atyre bashkëkohorë, me shembuj konkretë, në mënyrë që të jetë më i qartë.

Është një libër mesatar, mes doracak dhe librit voluminoz, ashtu që të jetë më i kapshëm, e jo “i frikshëm” në vëllim.

Gjithashtu është tejet e rëndësishme që muslimanët

të njohin zgjedhjen që Islami ua ka ofruar njerëzimit në zvogëlimin e varfërisë, në zhdukjen e egosë, në parandalimin e shkeljes së të dobët, të varfrit e nevojtarit, duke u ndihmuar atyre, duke i bërë ata të rëndësishëm në shoqëri dhe duke ua bërë me dije se dikush mendon për ta.

Sa u përket haditheve, jam munduar të theksoj gjykimin e dijetarëve të shkencës së hadithit përkitazi me to, ndërsa për transmetimet e sahabëve kam përmendur gjykimin në bazë të zinxhirit që kam pranë.

### ***Kuptimi i fjalës “Zekat”***

Fjala “zekat”, në gjuhën arabe, ka disa kuptime: shtim, më e mira e një gjëje, pastërti, zhvillim, bereqet etj. Është quajtur kështu ngase e shton dhe e zhvillon pasurinë.<sup>1</sup>

Ndërkaq, në terminologjinë fetare dijetarët kanë dhënë disa përkufizime:

1. Imam Ali Xhurxhani ka thënë: Obligimi i një pjese të pasurisë, në lloj të caktuar të pasurisë, për një pronar të caktuar.<sup>2</sup>
2. Njëri prej përkufizimeve të dijetarëve hanefi është:

---

1 Et-Tarifat, Ali ibn Muhamed el Xhurxhani, f. 152; El-Kamus el-muhit, Fejruz Abadi, f. 1667; Lisan-ul arab, vëllimi 14, f. 358, Ibn Mendhuri.

2 Et-Tarifat, Xhurxhani, f. 152.

T’i kalosh në pronësi një pjesë të caktuar të pasurisë, prej pasurisë së caktuar, një personi të caktuar, për Allahun e Madhëruar.<sup>3</sup>

3. Imam Ibn Kudame ka thënë: Detyrë obligative në pasuri.<sup>4</sup>
4. Ndër definicionet e dijetarëve bashkëkohorë po e përmend vetëm atë të dr. Abdullah Gufejlit, i cili thotë: “Pjesë e caktuar fetarisht, në pasuri të caktuar, ndaj kategorive të caktuara, në mënyrë të caktuar.”<sup>5</sup>

Sqarim i përgjithshëm i këtyre përkufizimeve:

“Pjesë e caktuar”, është për qëllim 2.5%.

“Në pasuri të caktuar”, është për qëllim: ari, argjendi, kafshët etj., prej të cilave nxirret zekati.

“Personit të caktuar”, ka për qëllim tetë kategoritë, të cilave u jepet zekati.

---

<sup>3</sup> El-Lubab fi sherhil kitab, vëllimi 1, f. 110.

<sup>4</sup> El-Mugni, Ibn Kudame, vëllimi 4, f. 5.

<sup>5</sup> Nevazil ez-zekat, Abdullah el Gufejli, f. 43.

## ***Rëndësia***

Zekati është shtylla e tretë e Islamit dhe, së bashku me namazin, në Kuranin fisnik është përmendur në shumë ajete kuranore. Allahu i Madhëruar thotë: **“Faleni namazin dhe jepeni zekatin.”**<sup>6</sup> Po ashtu obligimi i tij ka ardhur në shumë hadithe të të Dërguarit ﷺ. Prej tyre theksojmë hadithin e Abdullah ibn Omerit (Allahu qoftë i kënaqur me të), i cili tregon se i Dërguari ﷺ ka thënë: *“Islami është ndërtuar mbi pesë (shtylla): mbi dëshminë “la ilahe il-lallah ue enne Muhameden resulullah”, mbi faljen e namazit, dhënien e zekatit...”*<sup>7</sup>

Njashtu zekati ka qenë obligim edhe te të dërguarit ﷺ e mëhershëm. Allahu i Madhëruar, në lidhje me Ibrahimin ﷺ dhe pasardhësit e tij, thotë: **“Dhe ata i bëmë shëmbëlltysë që udhëzonin sipas urdhrin Tonë, i orientuam në punë të mira, në faljen e namazit, në dhënien e zekatit, dhe ata ishin adhurues Tanë të singertë.”**<sup>8</sup>

### **Objektivat (qëllimet) e zekatit**

1. Adhurimi i Allahut të Madhëruar, duke kryer një prej obligimeve më të mëdha; nuk është taksë, por është nënshtrim ndaj Allahut të Lartësuar, duke shpresuar

---

6 El Bekare, 43.

7 Shënon Buhariu, numër 8 dhe Muslimi, numër 16.

8 El Enbija, 73.

shpërblimin e madh prej Tij në Ditën e Gjykimit.

2. Falënderimi i Allahut për pasurinë që ia ka dhuruar njeriut.

Allahu i Madhëruar thotë: **“Dhe (rikujtoni) kur Zoti juaj njoftoi bindshëm: Nëse falënderoni, do t’juaj shtoj të mirat, e, nëse përbuzni, s’ka dyshim, dënimi Im është i vështirë!”**<sup>9</sup>

Nga ky këndvështrim themi se muslimani e ka obligim që ta falënderojë Allahun për begatinë e pasurisë që ia ka dhënë.

3. Pastrimi prej mëkateve. Allahu i Madhëruar thotë: **“Merr prej pasurisë së tyre lëmoshë që t’i pastrosh me të dhe t’u shtosh (të mirat)...”**<sup>10</sup>
4. Personi që e jep atë, shërohet prej vesit të koprracisë, sepse koprraci e ka shumë të vështirë të nxjerrë diç prej pasurisë së tij për t’ia dhënë dikujt. Ndërkaq, përmes dhënies së zekatit çlirohet nga ky ves dhe mësohet të japë.
5. Pastrimi i vetë pasurisë, sepse në pasurinë që e posedojmë kemi obligime kundrejt nevojtarëve. E, sikur kjo pasuri të mos u jepej atyre që duhet dhënë,

---

<sup>9</sup> Ibrahim, 7.

<sup>10</sup> Et Teube, 103.



bëhet e ndytë, por, nëse u jepet, ajo pastrohet.

6. Ndihma ndaj të varfërve dhe mbulimi i nevojave të tyre elementare, ashtu që edhe ata ta kenë një jetë më të lehtë e më fisnike. Po ashtu, kjo bëhet shkak për t'i larguar ata nga fitimi i pasurisë në mënyrë të ndaluar.
7. Shtimi i pasurisë. Allahu i Madhëruar thotë: **“Allahu zhduk kamatën dhe shton lëmoshën, Allahu nuk e do asnjë mohues dhe mëkatar.”**<sup>11</sup>
8. Thirrja islame. Dhënia e zekatit të varfërve i shtyn ata që edhe më tepër të kapen për fenë islame, si dhe në rastin kur ata janë kategori që dëshirojmë t’ua përfitojmë zemrën.<sup>12</sup>

## *Kushtet e zekatit*

### **1. Islami**

Jomuslimani nuk obligohet për të dhënë zekatin, siç nuk i kërkohet kryerja e asnjë obligimi tjetër fetar islam pa e pranuar Islamin.

---

11 El Bekare, 276.

12 Nevazil ez-zekat, Abdullah el Gufeji, f. 48; El-Mevsuatu el-fikhije, vëllimi 23, f. 230.

## 2. Arritja e nisabit

Nisabi është kufiri i caktuar fetarisht. Secila kategori e pasurisë, për të cilën obligohemi ta nxjerrim zekatin, e ka edhe kufirin përkatës, nisabin, që, nëse një person nuk e ka arritur atë, nuk e ka obligim për ta dhënë zekatin. Për shembull, nëse një person ka vetëm 70 euro, atëherë kjo pasuri nuk e ka arritur nisabin. Rrjedhimisht, themi se nuk e ka obligim që ta japë zekatin, sepse nuk e ka përmbushur njërin prej kushteve të zekatit, që është arritja e nisabit.

Argument për këtë kusht e kemi hadithin e Ebu Seid Hudriut (Allahu qoftë i kënaqur me të), i cili transmeton se i Dërguari ﷺ ka thënë: *“Nuk ka zekat në më pak se pesë evakë. Nuk ka zekat në më pak se pesë deve dhe nuk ka zekat në më pak se pesë evsukë.”*<sup>13</sup>

Evak është njësi matëse e argjendit. Kështu, një evak është i barasvlershëm me 40 dërhëmë. Pra, 5 evakë bëjnë 200 dërhëmë.

Evsuk është njësi matëse e drithërave dhe frutave apo kokrrave. Një evsuk është i barabartë me 60 saë, e një saë është e barabartë me 2.040 gramë.<sup>14</sup>

Nisabin e secilit lloj të pasurisë do të shtjellojmë më poshtë.

<sup>13</sup> Buhariu, numër 1405 dhe Muslimi, numër 979.

<sup>14</sup> Sipas shejh Uthejminit, mendim shumë të përafërt ka edhe dr. Abdullah el Gufeji, Nevazil ez-zekat, f. 103.

### **3. Qëndrimi i pasurisë një vit**

Nëse pasuria që e ka një person e ka arritur nisabin, atëherë pasuria në fjalë duhet të qëndrojë te ky person një vit (vit hënor d.m.th. 355 ditë), e pastaj të nxirret zekati, e jo të nxirret zekati sapo ta arrijë nisabin. Ky kusht vlen për arin, argjendin, paratë, mallrat shitëse dhe kafshët. Argument për këtë kusht e kemi hadithin e Aliut (Allahu qoftë i kënaqur me të), i cili transmeton se i Dërguarit ﷺ ka thënë: *“Nëse ke dyqind dërrhemë, të cilëve u kalon një vit...”*<sup>15</sup>

Në drithëra dhe në fruta apo kokrra zekati nxirret menjëherë pas korrjes apo vjeljes.

### **4. Liria, përkatësisht e kundërta e robërisë**

Dijetarët e vënë këtë kusht, ngaqë robëria ka qenë evidente deri në kohët e vonshme, ndërsa tani nuk gjendet. Sidoqoftë, robërit nuk e japin zekatin, sepse ai kërkohet vetëm prej atyre që janë të lirë.

### **5. Pasuria në fjalë duhet të jetë nën pronësinë ose nën posedimin e plotë të personit**

Rrjedhimisht, për pasuritë që nuk janë nën pronësi ose posedim të plotë të personit nuk jepet zekati, siç janë:

---

<sup>15</sup> Ebu Davudi, numër 1573, disa dijetarë e kanë saktësuar këtë si fjalë të Aliut, e jo si fjalë e të Dërguarit ﷺ, shih: Nesbur-raje li ehadith el-hidaje, vëllimi 2, f. 329. E njëjta gjë është transmetuar edhe prej sahabëve të tjerë, shih: Musanef ibn Ebi Shejbe, numër 9939, Darekutni, vëllimi 2, f. 91.

pasuria e humbur, vakëfet, shoqatat bamirëse etj., të cilat nuk janë në pronësi të plotë të ndonjë personi të caktuar.

### ***Zekati i arit dhe argjendit***

Këtu kemi të bëjmë me vlerat e arit dhe argjendit apo me paratë bashkëkohore, të cilat e zënë vendin e tyre.

Argumentet për këtë janë të shumta, porse këtu po e përmendim Fjalën e Allahut të Madhëruar, përmes së cilës u kërcënohet atyre që nuk e japin zekatin e pasurisë. Allahu i Madhëruar thotë: **“Ata që grumbullojnë ar e argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm.”**<sup>16</sup>

**Vlera e nisabit (mendimet e dijetareve rreth nisabit) dhe sasia e nxjerrjes.**

Nisabi apo kufiri i arit që duhet arritur është 85 gramë, kurse nisabi i argjendit që duhet arritur është 595 gramë.<sup>17</sup>

Ndërkaq, vlera e zekatit që duhet nxjerrë prej pasurisë është 2.5%.

Për shembull, nëse një person ka 200 gramë ar, atëherë ky e ka arritur nisabin. Pastaj, prej ditës që e ka arritur nisabin,

16 Et Teube, 34.

17 El-Fikhu el-islamij ve edil-letuhu, vëllimi 3, f. 182, Vehbe ez Zuhejli; Nevazil ez-zekat, f. 159, Abdullah el Gufejli; Fikhu ez-zekat, Jusuf el Kardavi, vëllimi 1, f. 260.

kjo pasuri duhet t'i qëndrojë një vit hënor, e në fund të nxirret 2.5% i saj. Për ta gjetur më lehtë këtë 2.5%, shikojmë vlerën që kemi dhe e pjesëtojmë me 40, barazimi i së cilës na jep vlerën që duhet ta japim për zekat. Në rastin tonë është  $200 : 40 = 5$ . Pra, duhet të jepen vetëm 5 gramë ar, prej gjithsej 200 gramë ar që kishim.

Kur jemi te paratë, duhet shikuar vlera e arit ose argjendit në monedhat bashkëkohore (bie fjala, në euro).

Nëse çmimi i arit për një gram është 37 euro, atëherë shumëzojmë:  $85 \times 37 = 3145$  euro. Domethënë, nisabi i parave, sipas arit, është 3145 euro.

Nëse çmimi i argjendit për një gram është 0.5 euro, atëherë shumëzojmë  $595 \times 0.5 = 297.5$  euro. Domethënë, nisabi i parave, sipas argjendit, është 297.5 euro.

Duhet pasur kujdes që të shikohet çmimi i arit apo argjendit, ashtu që të dihet saktë nisabi i tyre. Kjo, se çmimi i tyre ndryshon dhe varion pothuajse përditë.

Në kohët e mëhershme vlera e 85 gramëve ar ka qenë e barabartë apo e përafërt me 595 gramë argjend, andaj cilado prej tyre që arrihej, arrihej edhe nisabi.

Mirëpo, në kohën tonë, siç pamë më lart, dallimi mes dy vlerave është shumë i madh, ngase nisabi i arit është përafërsisht 2970 euro (më 27.3.2018), kurse nisabi i

argjendit është përafërsisht 260 euro (në po të njëjtën datë).

Nisur nga kjo, se cila vlerë duhet marrë për bazë, e arit apo e argjendit, dijetarët kanë dhënë tri mendime:

### **Mendimi i parë**

Duhet shikuar vlera apo çmimi i arit, ngase çmimi i tij është më i qëndrueshëm sesa i argjendit dhe se është i lartë (rreth 2970 euro në kohën tonë). Dhe, ai që e arrin atë, me të vërtetë hyn në kategorinë e të pasurve që duhet ta japin zekatin. Po ashtu çmimi i arit është më i afërt me nisabet e tjera, bie fjala, nisabi i lopëve (30 copë), deleve (40 copë) etj.

Këtë mendim e kanë: Jusuf Kardavi, Abdulkerim Zejdani, Vehbe Zuhejli (ky i fundit pohon se, sa i përket argumentimit, ky mendim është më i saktë, porse mendon se duhet të kapemi për mendimin e tretë, që do ta përmendim në vijim, ngase është më i përshtatshëm për të varfrit).<sup>18</sup>

### **Mendimi i dytë**

Duhet shikuar vlera apo çmimi i argjendit.

### **Mendimi i tretë**

Duhet shikuar vlera më e përshtatshme apo vlera që është në favor të të varfërve, e që në kohën tonë është vlera apo

18 Fikhu ez-Zekat, vëllimi 1, f. 264, El-Mufesal fi ahkam el-mereti, f. 367, Vehbe ez-Zuhejlij; El-Fikhu el-islamij ve edil-letuhu, vëllimi 3, f. 182.

çmimi i argjendit, që është shumë më i ulët sesa çmimi i arit.

Sipas këtij mendimi numri i dhënësve të zekatit rritet, gjë e cila është në favor të nevojtarëve. Këtë mendim e kanë shumë dijetarë bashkëkohorë,<sup>19</sup> siç janë: Komisioni i Përhershëm për Fetva i Arabisë Saudite, Sad Hathlani, Abdullah Gufejli, Halid Mushejkih<sup>20</sup> etj.

Ky mendim është më i saktë për disa arsye:

1. Nëse themi se duhet shikuar vlera më e ulët apo më e përshtatshme për të varfrit, atëherë ne e kemi arritur nisabin e të dy monedhave (arit dhe argjendit) dhe punojmë me atë që na ka urdhëruar feja: të arrijmë nisabin e arit ose argjendit, pa e përjashtuar asnjërin.

Ndërkaq, nëse merret parasysh vetëm vlera e arit, ne e përjashtojmë tërësisht vlerën e argjendit, e që zekati për vlerën e argjendit (dërhemit) është më i fortë për nga argumenti se dhe i vetë arit (dinarit).

2. Edhe për dispozita të tjera të zekatit dijetarët kanë përmendur se duhet shikuar ajo që është më e përshtatshme për të varfrit, siç është rasti i nisabit në mallrat tregtare, se a duhet shikuar me ari apo

---

<sup>19</sup> Siç potencon Vehbe ez Zuhejlj, El-Fikhu el-islamij ve edil-letuhu, vëllimi 3, f. 182.

<sup>20</sup> Fetava, vëllimi 9, f. 257; Fikhu el-muamalat el-malije el-muasira, f. 69; Nevazil ez-zekat, f. 160; Fikhu en-nevazil fil ibadat, f. 164.

argjend. Ebu Hanife dhe dijetarët hanbeli kanë thënë se duhet të shikohet nisabi më i përshtatshëm për të varfrit.<sup>21</sup>

3. Është më i sigurt, ngase, nëse e jep me vlerë të argjendit, lirohesh prej obligimit, veçanërisht kur e dimë se vlera e cila do të jepet është shumë e vogël dhe jepet vetëm një herë në vit.
4. Kur jemi tek argumenti i mendimit se nisabi i arit është më i afërt me nisabet e tjera (bie fjala, nisabi i kafshëve), themi se këto nisabe nuk bën t’i krahasojmë mes vete, sepse janë të përcaktuara me hadithe. Po ashtu, nëse punojmë sipas këtij krahasimi, themi se nisabi i grurit (miellit) është i afërt me nisabin e argjendit, mbase edhe më i vogël në çmim (612 kg grurë janë më pak se 300 euro).

Së këndejmi, nëse një person ka një shumë prej 1000 eurosh, atëherë, sipas mendimit të parë, nuk e ka obligim ta japë zekatin, sepse nuk e ka arritur nisabin.

Ndërkaq, sipas mendimit të dytë apo të tretë (që është më i sakti), ky person e ka arritur nisabin, andaj duhet ta japë zekatin (pasi të kalojë një vit hënor).

Për shembull, një person posedon 1500 euro. Atëherë,

21 El-Mebсут, Serahsi, f. 270; El-Mevsuatu el-fikhije, vëllimi 23, f. 272.



sipas mendimit të parë nuk obligohet ta japë zekatin, porse sipas mendimit të dytë duhet ta japë.

Po ashtu, kjo shumë prej 1500 eurosh duhet të qëndrojë një vit hënor, e pastaj të jepet zekati i saj.

Llogaria bëhet në këtë mënyrë:  $1500 : 40 = 37.5$  euro. Domethënë, duhet të japë vetëm 37.5 euro në vit.

### **Nëse pasuria e arrin nisabin, mirëpo pa e arritur vitin zbret nën nisab.**

Për ta kuptuar këtë çështje më mirë, po e ilustruam me një shembull: nëse një person posedon 4000 euro (në muajin muharrem, muaji i parë hënor), atëherë themi se e ka arritur nisabin. Mirëpo, ende pa kaluar një vit (bie fjala, në muajin e shtatë hënor), i shpenzon këto para, ashtu që i mbesin vetëm 50 euro, pastaj, pak kohë para se të kalojë viti hënor (muaji i dymbëdhjetë hënor), atij i bëhen 3500 euro.

Se a duhet dhënë zekatin e këtyre parave apo jo, kemi dy mendime të dijetarëve:

#### **Mendimi i parë**

Shumica e dijetarëve, Zuferi (prej hanefive), shafitë dhe hanbelitë thonë se, nëse pasuria që e ka arritur nisabin, pas një kohe (më pak se një vit) bie nën kufirin e nisabit,

atëherë nuk duhet të nxirret zekati për këtë pasuri, sepse nuk është përmbushur kushti i dytë, që është qëndrimi i kësaj pasurie një vit të plotë hënor.

Në rastin tonë, ky person prapë e fillon llogaritjen e kohës që kur e ka arritur nisabin për herë të dytë, domethënë në muajin e parë është arritur nisabi, pastaj në muajin e shtatë ka rënë nën kufirin e nisabit, pastaj prapë e ka arritur nisabin në muajin e dymbëdhjetë, atëherë themi: Llogaria e kohës prej muajit të parë është anuluar, porse ka filluar llogaria e kohës prej muajit të dymbëdhjetë.

### **Mendimi i dytë**

që është mendimi i dijetarëve hanefi, se, në këtë rast duhet të shikohen vetëm dy skajet e vitit, skaji i parë, kur është arritur nisabi, dhe skaji i dytë, pas një viti hënor. Ndërkaq, që çdo ditë të shikohet se sa para i ka dhe a kanë rënë nën nisab, është shumë e vështirë.

Pra, shikohet muaji i parë (muharrem) që e ka arritur nisabin dhe prapë e shikojmë pas një viti muajin muharrem se sa para i ka, pa marrë parasysh nëse kjo pasuri ka rënë apo nuk ka rënë nën kufirin e nisabit përgjatë muajve të kaluar.<sup>22</sup>

22 Hashijetu ibn Abidin, vëllimi 3, f. 233; El-Mebсут, Serahsi, f.259; El-Mevsuatu el-fikhije, vëllimi 23, f. 244.

Mendimi i parë është më i saktë për shkak se kushti i qëndrimit të kësaj pasurie për një vit nuk është përmbushur. Në hadithin e Aliut (Allahu qoftë i kënaqur me të) qëndron: “*Nëse ke dyqind dërhëmë dhe atyre u kalon një vit...*”<sup>23</sup> Pra, parave duhet t’u kalojë një vit, e, nëse ato janë harxhuar, nuk mund të themi se kanë qëndruar një vit.

Shembulli i parë: nëse një person ka një pagë mujore prej 500 eurosh, atëherë themi:

Ky person e ka arritur nisabin.

Shikohet kjo pasuri a e kalon një vit pa u harxhuar (zakonisht në shoqërinë tonë pagat sikurse kjo jo që nuk qëndrojnë një vit, porse harxhohen ende pa përfunduar muaji).

Prandaj, themi se ky person nuk e jep zekatin, sepse paga të cilën e merr, nuk i qëndron një vit, do të thotë nuk e plotëson kushtin e dytë.

Shembulli i dytë: nëse një person ka një pagë mujore prej 630 eurosh dhe se për çdo muaj arrin të mbledhë diç prej të ardhurave të tij dhe se pas disa muajsh ky person e arrin nisabin pa rënë nën të. Atëherë prej muajit që e ka arritur nisabin, bie fjala, prej muajit Ramazan, presim

---

<sup>23</sup> Ebu Davudi, numër 1573.

një vit hënor dhe në fund llogarisim:

1. Shumën e mbledhur pas një viti, ta zëmë, 1250 euro.
2. Plus shumat e tjera që i ka në llogaritë bankare, në xhep etj., bie fjala, 115 euro.

Pra kemi  $(1250 + 115) : 40 = 34.13$  euro.

### ***Zekati i stolive***

Shumica e dijetarëve janë të mendimit se nuk ka zekat në stolitë të cilat i përdor gruaja (vathët, qaforet, byzylykët etj.), sepse këto janë gjëra të cilat përdoren siç përdoren rrobat.<sup>24</sup>

Ndërkaq, dijetarët hanefi e obligojnë zekatin në to, siç është obligim në dinarë dhe dërhëmë, ngase argumentet që e obligojnë zekatin nuk bëjnë dallimin mes parave dhe stolive, porse përfshijnë çdo gjë që ka të bëjë me ar dhe argjend.<sup>25</sup>

Ajo që e bën më të zgjedhur dhe më të fortë mendimin e parë janë transmetimet e shumë sahabëve të cilët nuk e obligojnë zekatin në stoli, si: Xhabir ibn Abdullahu<sup>26</sup>,

24 El-Mugni, vëllimi 4, f. 220.

25 El-Mebсут, Serahsi, f. 271; Bedaius-Sanai, vëllimi 2, f. 17.

26 El-Emval, Ebu Ubejd Herevi, numër 1275; Musanef Abdurrezak, numër 7046, me zinxhir të saktë.

Abdullah ibn Omeri<sup>27</sup>, Aishja<sup>28</sup>, Esmâ bint Ebu Bekri<sup>29</sup>, Enes ibn Maliku<sup>30</sup> etj., edhe pse, sikur të ishte vetëm transmetimi i Aishes, gruas së të Dërguarit ﷺ, do të ishte i mjaftueshëm.

Hasen el Basriu të njëjtën gjë na e transmeton prej katër halifëve të drejtë, duke thënë: “Nuk dimë se ndonjëri prej halifëve e ka obliguar zekatin në stoli.”<sup>31</sup>

Po ashtu Ebu Ubejd Hereviu, në librin e tij “El Emval” (Pasuritë), e përkrah këtë mendim, duke bërë dallim mes parave të asaj kohe, dinarit dhe dërhemit, për të cilat kanë ardhur argumentet se duhet dhënë zekati, dhe stolive, të cilat janë vetëm zbukurim, po edhe gjuhësisht fjalët “dinar” e “dërhem” tek arabët nuk kanë qenë të njohura se nënkuptojnë edhe stolitë.<sup>32</sup>

Mbetet çështja e haditheve të transmetuara nga i Dërguari ﷺ, të cilat e obligojnë dhënien e zekatit në stoli. Mirëpo, dijetarët e hadithit, siç janë: imam Tirmidhiu, Hafidh ibn Rexhebi etj., kanë potencuar se të gjitha këto hadithe ose kanë dobësi në zinxhirin e tyre,<sup>33</sup> ose janë argumente të përgjithshme, që e obligojnë zekatin në para, porse jo në

---

27 El-Emval, Ebu Ubejd Herevi, numër 1276; Musanef Abdurrezak, numër 7047, me zinxhir të saktë.

28 Musanef Abdurrezak, numër 7051, 7052, me zinxhir të saktë.

29 Musanef ibn Ebi Shejbe, numër 10178, me zinxhir të saktë.

30 Sunen Darukutni, numër 1965, por në zinxhirin e tij ka dobësi.

31 Musanef ibn Ebi Shejbe, numër 10181, me zinxhir të mirë.

32 El-Emval, Ebu Ubejd Herevi, f. 542.

33 Sunen Tirmidhi, vëllimi 2, f. 23; Ahkam el-havatim, f. 114.

stoli, të cilat përdoren në jetën e përditshme.

Po ashtu shumë dijetarë bashkëkohorë janë të mendimit se zekati në stoli nuk është obligim. Sa për ilustrim po përmend disa syresh: Abdullah Feuzani, Abdullah ibn Abdulaziz Xhibrini, Furejh Behlali, Jusuf Kardavi<sup>34</sup> etj.

### ***Zekati i mallrave tregtare***

Këtu kemi të bëjmë me çdo lloj malli që është në shitje, pa marrë parasysh çfarë lloji është, bie fjala, këpucë, rroba, pemë, automjete, banesa etj. Në të gjitha këto lloje duhet të jepet zekati, ngase janë mallra të cilat shiten.

Argument për këtë kemi ajetin: **“O ju që besuat, jepni prej të mirave që keni fituar dhe prej atyre që Ne jua nxorëm juve prej tokës.”**<sup>35</sup> Këtu hyjnë mallrat tregtare, prej të cilave njerëzit fitojnë.

Si dhe ajetin: **“Merr prej pasurisë së tyre lëmoshë që t’i pastrosh me të dhe t’u shtosh (të mirat...)”**<sup>36</sup>, edhe këtu hyjnë mallrat tregtare.

Se për këtë lloj pasurie duhet dhënë zekat është transmetuar edhe prej sahabëve, njëherazi ky është mendimi i katër

34 Minhatul alam, vëllimi 4, f. 437; Sherh umdetul fikh, vëllimi 1, f. 512; Imtinan el-alij bi ademi zeketul hulij; Mexhmuatu resail mufideh, vëllimi 3, f. 157; Fikhu ez-zekat, f. 292.

35 El Bekare, 267.

36 Et Teube, 103.

dijetarëve të mëdhenj të medhhebeve, si dhe i shtatë fukahave të njohur, saqë Ibn Mundhiri ka potencuar ixhmain, përkatësisht konsensusin e dijetarëve se në mallrat tregtare ka zekat.<sup>37</sup>

Sasia e nxjerrjes është 2.5%, siç është te monedhat.<sup>38</sup>

Kushtet e këtij lloji:

1. Nijeti apo qëllimi se këtë mall apo pasuri e ka për tregti e jo për shfrytëzim personal. Ta zëmë, nëse një person posedon pesë automjete në vlerë prej 15000 eurosh, të cilat i mban për t'i shitur, atëherë në këtë lloj duhet të nxirret zekati. Ndërkaq, nëse këto pesë automjete i mban për vete, pa pasur për qëllim shitjen e tyre, nuk duhet të japë zekat për to.
2. Arritja e nisabit, sikurse te paratë.
3. Qëndrimi i pasurisë një vit hënor (355 ditë).

Shembull: në rastin e lartpërmendur, nëse personi në fjalë posedon 5 automjete, vlera e të cilave është 15000 euro dhe këto automjete i ka për shitje, atëherë themi:

1. Kushti i parë, që është qëllimi për tregti, është plotësuar.

---

37 El-Mebсут, vëllimi 1, f. 270; El-Mugni, vëllimi 4, f. 248; Muhtesar fil ibadat, Mushejkih, f. 207.

38 Bedaius-senai, vëllimi 2, f. 21.

2. Kjo pasuri ka arritur nisabin, sepse kap vlerën 15000 euro.
3. Prej ditës kur i ka nxjerrë për tregti duhet të presë një vit hënor, e më pas ta llogarisë vlerën e tyre sa është në fund të vitit (e jo sa ka kanë pasur vlerë kur i ka blerë) dhe ta japë 2.5% e saj. Nëse në fund të vitit, kur duhet ta nxjerrë zekatin, vlera e automjeteve që i ka në shitje është 16000 euro, atëherë 2.5% i saj është:  $16000 : 40 = 400$ . Pra, vlera e cila duhet dhënë për zekat është 400 euro.

Llogaritja e mallit bëhet duke vlerësuar mallin tregtar që posedon, pasi të kalojë një vit hënor, me vlerën apo çmimin që ka në kohën kur bëhet obligim të jepet, pavarësisht vlerës apo çmimit që është blerë para një viti.<sup>39</sup> Me fjalë të tjera, sipas çmimit që shitet, e jo sipas çmimit që e ka blerë.<sup>40</sup>

Shembull tjetër: një person ka një hapur dyqan ushqimor në vlerë prej 12000 eurosh, përfshirë qiranë, raftet, frigoriferët dhe mallin që do të shitet.

Pas një viti hënor llogarisim:

1. Vetëm vlerën e mallit që shitet, bie fjala, 10000 euro.
2. Plus paratë që i ka kursyer, të cilat nuk i ka shpenzuar,

39 El-Mevsuatu el-fikhije, vëllimi 23, f. 274; Komisioni i Përhershëm për Fetva, vëllimi 9, f. 320.

40 Muhamed Munexhid, islamqa, numër 65515.



bie fjala, 1500 euro.

3. Paratë që i ka shpenzuar për nevoja familjare nuk llogariten fare.
4. As gjërat që nuk shiten nuk llogariten fare, siç janë: raftet, frigoriferët etj., që do ta sqarojmë më vonë.

Pra, kemi  $(10000 + 1500) : 40 = 287.5$  euro, të cilat duhet të jepen për zekat.

## ***Fabrikat***

Kur jemi te fabrikat, duhet të bëjmë dallimin mes mjeteve apo makinave që prodhojnë, mes lëndës së parë, prej së cilës do të prodhohet produkti, dhe mes mallit që është prodhuar për të dalë në treg.

1. Për mjetet apo makinat që prodhojnë, nuk duhet dhënë zekat, sepse ato janë gjëra që posedohen dhe nuk shiten.<sup>41</sup> E, për gjërat që përdoren dhe nuk janë për shitje, i Dërguari ﷺ ka thënë: “*Muslimani nuk obligohet të japë zekat për kalin e as për robin e tij.*”<sup>42</sup>

Ka dhe mendim tjetër, sipas të cilit edhe për këto gjëra

---

41 Këtë mendim e kanë: Mushejkijh, Fikhu en-nevazil fiz-zekat, f. 201; Mexhma el-fikh el-islamij; Abdullah el Gufeji, En-nevazil fiz-zekat f. 134.

42 Buhariu, numër 1463 dhe Muslimi, numër 982.

duhet të jepet zekati.<sup>43</sup>

Mirëpo, mendimi i parë është më i saktë, për shkak të hadithit të sipërpërmendur dhe për faktin se këto nuk hyjnë në mallra që shiten apo që dalin në treg, porse janë vetëm gjëra të cilat përdoren, sikundër që përdoren rrobat, veglat e shtëpisë etj.

2. Lënda e parë prej së cilës do të prodhohet produkti, siç është mielli në fabrikën e bukës, alumini në fabrikën e dritareve, druri në fabrikën e orendive etj.

Shumica e dijetarëve janë të mendimit se edhe për këto duhet dhënë zekat, sepse edhe këto janë mallra tregtare që do të shiten.<sup>44</sup>

3. Malli i prodhuar. Edhe për këtë duhet të jepet zekati, sepse është mall tregtar i cili shitet.<sup>45</sup>

Shembulli i parë: një fabrikë e bukës për çdo ditë prodhon bukë dhe produkte të tjera të grurit në vlerën që e arrin nisabin. Pronari, pas një viti, posedon gjithsej 3300 euro mall shitës, plus 3000 euro lëndë të parë (miell, vaj etj.). Kështu, e llogarit shumë prej 3300 eurosh, plus 3000 euro të lëndës së parë dhe paratë e tjera të depozituara e që nuk

43 Jusuf el Kardavi, Fikhu zekat, vëllimi 1, f. 458.

44 Fikhu en-nevazil fil ibadat, f. 202, Mushejkih; En-nevazil fiz-zekat, f. 141, Abdullah el Gufejli.

45 Fikhu en-nevazil fil ibadat, f. 199, Mushejkih; En-nevazil fiz-zekat, f. 141, Abdullah el Gufejli.

i ka shpenzuar, ta zëmë, 2000 euro.

Pra, njehson:  $(3300 + 3000 + 2000) : 40 = 207.5$  euro

Dhe del se vetëm 207.5 euro është shuma që duhet ta japë për zekat.

Shembulli i dytë: një person ka blerë një tokë në vlerë 50000 euro, me qëllim që ta shesë. Pas një viti vlera apo çmimi i tokës është ngritur, në 55000.

Atëherë, ky person duhet të japë për zekat:  $55000 : 40 = 1375$  euro.

### **Gjërat të cilat nuk hyjnë këtu**

Për mjetet të cilat tregtari i përdor në biznesin e tij, që nuk i ka në shitje, porse përdoren në biznes, siç janë: raftet, tavolinat, karriget, makinat e prodhimit, kompjuterët, mjetet e transportit, frigoriferët etj., nuk jepet zekat.

Po ashtu për mjetet që jepen me qira, siç janë: shtëpitë, banesat, lokalet, automjetet, veglat e punës etj., nuk jepet zekat, sepse në këtë rast nuk llogariten mall tregtar. Mirëpo, nëse paratë që fitohen prej kësaj qiraje e arrijnë nisabin, atëherë obligohet për të dhënë zekatin e parave.<sup>46</sup>

---

46 El-Mevsuatu el-fikhije, vëllimi 23, f. 274; Muhtesar fil ibadat, f. 208.

## ***Zekati i bagëtive***

Duhet theksuar se te bagëtitë, krahas kushteve të lartpërmendura, duhet shtuar edhe dy kushte të tjera:

1. Duhet të jenë për qumësht ose për shtim, ndërsa për lopët që mbahen për punë, nuk jepet zekat (kjo vlen për kohët e mëhershme, kur lopët i mbanin për të lëvruar tokën).<sup>47</sup>
2. Që kafsha të kullosë tërë vitin ose shumicën e vitit nëpër kullosa. Nëse kafshët gjatë gjithë vitit ose të shumtën e vitit ushqehen me ushqim të blerë, atëherë për to nuk obligohemi të japim zekat.<sup>48</sup>

Bagëtitë për të cilat është obligim të nxirret zekati janë:

### **Devetë**

Meqë nuk gjenden në trevat tona, nuk do të flas për dispozitat e dhënies së zekatit për to.

### **Lopët**

Argument për obligimin e dhënies së zekatit për lopët është Suneti dhe konsensusi i dijetarëve (ixhmai).

Po ashtu dijetarët e obligojnë dhënien e zekatit edhe në

---

<sup>47</sup> Bedaius-senai, vëllimi 2, f. 30; El-Lubab fi sherh el-kitab, vëllimi 1, f. 112; El-Muhtesar fil ibadat, f. 192.

<sup>48</sup> Bedaius-senai, vëllimi 2, f. 30; El-Mugni, vëllimi 4, f. 13.

buallica.<sup>49</sup>

Prej Sunetit kemi hadithin e Ebu Dherrit (Allahu qoftë i kënaqur me të), i cili tregon se i Dërguari ﷺ ka thënë: *“Nuk ndodh që një pronar të ketë deve ose lopë ose dele, e të mos e japë zekatin e tyre, përveçse ato Ditën e Gjykimit do të sillen shumë të mëdha e të shëndosha, do ta shkelin me thundra dhe do ta godasin me brirët e tyre.”*<sup>50</sup>

Kështu, nëse numri i lopëve arrin në 30, atëherë jepet një lopë njëvjeçare, e, nëse numri i lopëve arrin në 40, atëherë jepet një lopë dyvjeçare.

Argument kemi hadithin e Muadh ibn Xhebelit (Allahu qoftë i kënaqur me të), të cilin i Dërguari ﷺ e dërgoi në Jemen dhe e urdhëroi të marrë prej çdo tridhjetë lopësh një lope njëvjeçare, qoftë femër apo mashkull, e, prej çdo dyzet lopësh, një lopë dyvjeçare...<sup>51</sup> Pastaj për çdo 30 lopë shtohet nga një lopë njëvjeçare, ndërsa për çdo 40 lopë shtohet një lopë dyvjeçare.

Për shembull, nëse një person i ka 70 lopë, ai duhet të japë një lopë njëvjeçare (për 30 lopë) dhe një lopë dyvjeçare (për 40 lopë).

49 El-Mugni, vëllimi 4, f. 34; Hashijetu Ibn Abidin, vëllimi 3, f. 203.

50 Shënon Buhariu, numër 1460 dhe Muslimi, numër 990.

51 Shënon Ebu Davudi, numër 1576; Tirmidhiu, numër 623; Nesaiu, numër 2449; Ibn Maxhe, numër 1803 dhe Ahmedi 36/338. Imam Tirmidhiu dhe Darekutniu e cilësojnë si mursel, që ka shkëputje në zinxhir, porse nuk ka mospajtim te dijetarët se zekati i lopëve është sikurse në këtë hadith të Muadhrit, siç citon Ibn Abdulberri (El-Istidhkar 3/188).

Shembulli i dytë: nëse një person posedon një fermë me 50 lopë, të cilat i ushqen me ushqim të blerë, porse i mban për t'i shitur, vlera e përgjithshme e të cilave është 40000 euro, në këtë rast themi:

1. Kushti i dytë, që është të ushqyerit në kullosa të shumtën e vitit, nuk është plotësuar, andaj nuk jepet zekati i kafshëve.
2. Ngaqë këto lopë i ka për shitje, atëherë llogariten si mallra tregtare. Pra, pasi të kalojë një vit hënor, llogarit sa është çmimi i përgjithshëm i lopëve, bie fjala, 35000 euro, plus paratë e fituara që nuk i ka harxhuar, ta zëmë, 3000 euro, dhe pjesëtohet me 40, për të na e dhënë 2.5%, që duhet ta nxjerrë për zekat.

Pra,  $(35000 + 3000) : 40 = 950$  euro.

Shembulli i tretë: një person posedon një fermë me 60 lopë, të cilat i ushqen brenda fermës dhe i mban për shitjen e qumështit dhe produkteve të tij, në këtë rast themi:

1. Nuk është arritur kushti i të ushqyerit të shumtën e vitit në kullosa, andaj nuk jepet zekati i lopëve.
2. Shikohet fitimi i qumështit a e ka arritur nisabin, që në rastin tonë sigurisht që arrihet shumë shpejt dhe, pasi të kalojë një vit, jepet 2.5% i pasurisë së fituar. Ta zëmë, paratë e fituara prej qumështit, të cilat nuk

i ka harxhuar, janë 1900 euro, plus paratë e tjera që i posedon në vlerë prej 600 eurosh. Pra,  $(1900 + 600) : 40 = 62.5$  euro.

3. Duhet pasur kujdes se në këtë shembull tonin nuk llogaritet çmimi i lopëve, sepse ato nuk janë në shitje, përkatësisht nuk janë mall tregtar.

### **Delet dhe dhitë**

Argument për obligimin e dhënies së zekatit në dele është Suneti dhe konsensusi i dijetarëve (ixhmai).

Një prej argumenteve kemi hadithin e gjatë të cilin e transmeton Enesi se Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur me ta) i kishte shkruar atij një shkrim, përmes të cilit i tregonte sesi i Dërguari ﷺ llogariste dhënien e zekatit në deve dhe në dele.<sup>52</sup>

Prej hadithit në fjalë nxjerrim këtë përfundim:

Prej 40-120 delesh jepet një dele (d.m.th. në më pak se 40 dele nuk nxirret zekati).

Prej 121-200 sosh jepen dy dele.

Prej 201 sosh e më tepër jepen tri dele.

Kjo vlen deri kur numri i tyre shkon në 400, pastaj, nëse

---

<sup>52</sup> Shënon Buhariu, numër 1454.

numri i deleve arrin në 401, jepen 4 dele, e kështu vazhdon (pas numrit 401), për çdo njëqind dele shtohet një dele.

Sipas disa dijetarëve, mosha e deles që duhet të jepet për zekat duhet të jetë mbi gjashtë muaj e, sipas disa të tjerëve, shtatë apo tetë muaj.

Ndërkaq, nëse është dhi, duhet të jetë njëvjeçare.<sup>53</sup>

Për shembull: një person posedon një kope me 170 dele, të cilat të shumtën e vitit i ushqen nëpër kullosa. Atëherë pasi ky person i plotëson kushtet e zekatis të deleve, duhet t'i japë dy dele.

Shembulli i dytë: një person posedon një fermë me 170 dele, të cilat i ushqen brenda fermës dhe se ato i mban për t'i shitur. Atëherë themi:

1. Ky person nuk duhet ta japë zekatin e deleve, ngase nuk e përmbush njërin prej kushteve të zekatis të bagëtive.
2. Kjo fermë tani llogaritet si mall tregtar, andaj duhet ta japë zekatin e mallit tregtar. Kështu, duhet të llogarisë çmimin e 170 deleve, ta zëmë, 20400 euro, plus paratë e fituara që nuk i ka harxhuar më parë, ta zëmë, 1100 euro. Pra,  $(20400 + 1100) : 40 = 537.5$  euro.

53 El-mugni, vëllimi 4, f. 49 dhe Hashijetu Ibn Abidin, vëllimi 3, f. 205.



## **Përzierja e bagëtive**

Në hadithin e njohur të rregullave të zekatit ka ardhur: “Nuk lejohet të bashkohet e ndara (kopeja) e as të ndahet e bashkuara, nga frika e zekatit.”<sup>54</sup>

Së këndejmi, themi: Nëse tre persona kanë nga 40 dele, atëherë nuk bën që të tillët t’i bashkojnë delet e tyre, ashtu që të mos japin tri dele për zekat (në çdo 40 nga një) me qëllim që të japin vetëm një dele (sepse deri në 120 dele jepet vetëm një).

Po ashtu, nëse dy persona kanë një kope të përbashkët me dyzet dele, është e ndaluar që, kur të vijë koha e zekatit (e në atë rast duhet të japin një dele), ata të bëjnë ndarjen e deleve në dy grupe nga njëzet dele, në mënyrë që t’i ikin zekatit.

## ***Zekati i drithërave dhe i frutave apo kokrrave***

Se në këtë lloj obligohet të jepet zekati, kemi argumente nga Kurani, Suneti dhe konsensusi i dijetarëve (ixhmai).

Allahu i Madhëruar thotë: **“O ju që besuat, jepni prej të mirave që keni fituar dhe prej atyre që Ne jua nxorëm juve prej tokës.”**<sup>55</sup>

---

54 Shënon Buhariu, numër 1450.

55 El Bekare, 267.

Prej Sunetit kemi hadithet e Ebu Seid Hudriut dhe Abdullah ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me ta), të cilat do t'i përmendim në vijim.

Kushtet e këtij lloji:

### 1. Arritja e nisabit.

Ebu Seid el Hudriu transmeton se i Dërguari ﷺ ka thënë: *“Nuk ka zekat në më pak se pesë evsukë të hurmave e as të të kokrrave.”*<sup>56</sup>

Evsuk është njësi matëse e barabartë me 60 saë.

Ndërkaq, 1 saë është e barabartë me 2.040 gramë<sup>57</sup>, kështu që kemi:  $5 \times 60 \times 2.040 = 612 \text{ kg}$ .

Domethënë, nisabi i drithërave apo kokrrave është 612 kilogramë.

2. Të jetë nën pronësinë e tij gjatë kohës kur i është bërë obligim. Nëse një person ka blerë 1000 kg miell, atëherë ai nuk e jep zekatin, sepse zekatin a këtij gruri duhet ta japë vetëm pronari që e ka mbjellë dhe e ka korrur grurin.

Llojet për të cilat duhet dhënë zekat janë: gruri, elbi,

56 Shënon Buhariu, numër 1459 dhe Muslimi, numër 979, teksti është i Muslimit.

57 Sipas shejh Uthejminit, Esh-Sherh el-Mumtië, vëllimi 6, f. 72, mendim shumë të përafërt ka edhe dr. Abdullah el Gufejli, Nevazil ez-zekat, f. 103. Dr. Jusuf el Kardavi thotë se një saë është e barabartë me 2176 gramë, andaj nisabi i drithërave dhe i kokrrave sipas tij është 653 kg, Fikhu ez-zekat, vëllimi 1, f. 372.

hurma, rrushi i terur<sup>58</sup>, orizi, misri etj. Pra, janë drithëra dhe fruta apo kokrra që ruhen gjatë.

Ndërkaq, për pemët dhe perimet vijuese: mollët, dardhat, qershitë, shalqiri, pastaj patatet, domatet, trangujt, specat e të ngjashme, nuk jepet zekat, ngase ato nuk ruhen gjatë.

Sqarimin e mësipërm e përkrahin shumica e dijetarëve, siç janë: Ebu Jusufi dhe Muhamedi, nga radhët e hanefive, pastaj malikitë, shafitë, hanbelitë, e që këtë mendim e përzgjedh Ibn Kudame dhe shumë dijetarë bashkëkohorë, edhe pse kanë disa dallime të vogla mes vete në përkufizimin e këtyre llojeve.<sup>59</sup>

## Sasia e nxjerrjes së zekatit

Abdullah ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se i Dërguari ﷺ ka thënë: **“Për atë që e ka ujitur qielli dhe burimet apo që e thith vetvetiu (prej nëntokës), duhet (dhënë) një e dhjeta, e, nëse është ujitur me spërkatje, atëherë (duhet dhënë) gjysma e një të dhjetës.”**<sup>60</sup>

---

58 Për këto katër gjëra ka konsensus të dijetarëve, El Mugni, vëllimi 4, f. 154.

59 El Mugni, vëllimi 4, f. 155; El-Mebsut, vëllimi 1, f. 286; El-fikhu el-islamij ve edil-letuh, vëllimi 3, f. 1882.

60 Shënon Buhariu, numër 1483.

Prej këtij hadithi kuptojmë se, për gjërat që ujitën prej qiellit (shiut), lumit, burimit etj., duhet dhënë 10% zekat, sepse personi që i ka mbjellë këto gjëra, nuk është lodhur dhe nuk ka shpenzuar pasuri për t'i ujitur ato.

Ndërkaq, nëse ky person është lodhur për t'i ujitur, ka shpenzuar në blerjen e mjeteve për ujitje dhe i ujit ato me këto mjete, atëherë ky duhet të japë vetëm 5% prej asaj që ka nxjerrë toka (prej drithërave apo kokrrave).

Për shembull: nëse një person ka një arë të mbjellë me grurë, prej së cilës ka korrur 2000 kg grurë, atëherë themi:

1. Nëse është ujitur prej shiut, duhet të llogarisë 10% e 2000 kg, që i bie se zekat duhet të japë 200 kg.
2. Nëse e ka ujitur me vegla dhe ka bërë harxhime për ujitje, duhet të llogarisë 5% e 2000 kg, që i bie se zekat duhet të japë 100 kg.
3. Ekziston mundësia që kjo arë të ujitet edhe me shi, edhe me vegla, atëherë ky duhet ta japë 7.5%, që i bie se zekat duhet dhënë 150 kg grurë.

Shembulli dytë: nëse një person posedon një arë të mbjellë me grurë, ujitja e së cilës është bërë me mjete dhe se prej saj ka korrur 3000 kg grurë, mirëpo grurin në fjalë e ka mbjellë me qëllim që ta shesë, në këtë rast themi se ky person duhet të japë njërin prej dy llojeve të zekatit:

1. Ose zekatin e grurit,
2. Ose zekatin e mallit tregtar.

Një pjesë e dijetarëve kanë zgjedhur mendimin se duhet dhënë vetëm zekatin e grurit, pra, llogaritet vetëm 5% i 3000 kg grurë, që i bie se duhet dhënë 150 kg grurë.

Në rastin tonë, të gjithë dijetarët janë të mendimit se zekati nuk nxirret dy herë (zekati i grurit dhe mallit tregtar), por vetëm njëri lloj.

Mendim më i zgjedhur është se duhet të jepet vetëm zekati i grurit, sepse, për nga argumenti, zekati i grurit është më i fuqishëm sesa i mallit tregtar dhe se në esencë njerëzit i mbjellin drithërat për tregti, mirëpo sheriat ka obliguar zekatin vetëm në drithëra.<sup>61</sup>

## ***Zekati i mjaltit***

Sa i përket zekatit të mjaltit, dijetarët kanë dhënë dy mendime:

### **Mendimi i parë**

dijetarët maliki dhe shafi nuk e obligojnë nxjerrjen e zekatit të mjaltit, për shkak se të gjitha hadithet që e obligojnë atë, janë të dobëta, siç thonë imamët: Buhariu, Tirmidhiu dhe

---

61 Nevazil ez-zekat, Abdullah el Gufeji f. 112.

Ibn Mundhiri.<sup>62</sup>

## Mendimi i dytë

Dijetarët hanefi e obligojnë atë në rast se bletët janë në tokën e pronarit, prej së cilës nxirret zekati. Po ashtu dijetarët hanbeli e obligojnë atë, mirëpo pa kushtin e sapopërmendur të dijetarëve hanefi. Argumentet e tyre janë hadithet që flasin për këtë temë.<sup>63</sup>

Mendimi i parë është më i fortë, për disa arsye, por po i përmend vetëm dy:

1. Hadithet që e obligojnë atë janë të dobëta.
2. Omer ibn Abdulazizi nuk e obligonte nxjerrjen e zekatit të mjaltit.<sup>64</sup>

## ***Kategoritë të cilave u jepet zekati***

Allahu i Madhëruar e ka kufizuar dhënien e zekatit në tetë kategori njerëzish, kategori këto jashtë të cilave nuk është e lejuar të jepet. Allahu i Madhëruar thotë: **“Lëmosha e zekatit është vetëm për të varfrit, për nevojtarët, për ata që janë ngarkuar me mbledhjen e tij, për ata të cilëve duhet përfituar zemrat, për lirimimin e skllëvërve,**

62 Fet-hul Bari, f. 407; El-Mevsuatu el-fikhije, vëllimi 23, f. 290.

63 Hashijetu ibn Abidin, vëllimi 3, f. 264; El-Mevsuatu el-fikhije, vëllimi 23, f. 290.

64 Shënon Ibn Ebu Shejbe, numër 10056, 10057.

**për të rënduarit nga borxhet, në rrugën e Allahut dhe për udhëtarin e mbetur rrugëve. Këto janë detyrat e vëna prej Allahut. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijsëm dhe i Urtë.”<sup>65</sup>**

Sqarimi i këtyre tetë kategorive:

- 1. Të varfrit** (*fukara*), janë ata që posedojnë diç prej pasurisë, mirëpo ajo nuk u mjafton për t'i mbuluar shpenzimet e vitit.
- 2. Nevojtarët** (*mesakin*), janë ata që nuk kanë fare pasuri.<sup>66</sup>

Ndërkaq, disa dijetarë të tjerë kanë thënë: Të varfrit (*fukara*) janë në gjendje më të rëndë se nevojtarët (*mesakin*), sepse të varfrit nuk kanë asgjë apo kanë shumë pak, kurse nevojtarët kanë diç më shumë, porse kjo nuk u mjafton për nevojat vjetore.<sup>67</sup>

Prej këtyre dy kategorive shohim se, për atë që e pranon zekatin, nuk është kusht të jetë njeri me kushte shumë të rënda ekonomike, por mjafton që të hyrat financiare që ka ai, të mos i mjaftojnë për një vit atij dhe familjes së tij.

---

65 Et Teube, 60.

66 El-Muhtar lil fetva, f. 163, Hashijetu ibn Abidin, vëllimi 3, f. 283.

67 El-Xhamië li ahkam el-Kuran, Kurtubi, vëllimi 8, f. 168.

**3. Ata që janë ngarkuar me mbledhjen e zekatit.**

Këta i cakton prijësi i muslimanëve dhe se paguhen në bazë të punës që bëjnë gjatë mbledhjes së zekatit. Ndërkaq, nëse pagat e tyre i kanë nga arka e shtetit, atëherë nuk u jepet prej zekatit.<sup>68</sup>

**4. Ata të cilëve duhet përfituar zemrat, të cilët ndahen në disa lloje:**

a. Personi që shpresohet se do ta pranojë Islamin, atëherë i jepet që t'i përfitohet zemra,

b. Personi që është bërë musliman, mirëpo, me dhënien që do t'i bëhej, do të forcohej më shumë në fe, dhe

c. Personi që ka pushtet, ashtu që, nëse i jepet, do të ndalet prej dëmtimit të besimtarëve.<sup>69</sup>

**5. Për lirim të skllëvërve, në këtë kategori, në kohën tonë, hyjnë të burgosurit.<sup>70</sup>**

**6. Për të rënduarit nga borxhet, të cilët ndahen në dy lloje:**

a. Atij që merr borxh për t'i pajtuar njerëzit, për të ndalur gjakderdhjen mes njerëzve etj., i lejohet të marrë prej zekatit, në mënyrë që të ndërmjetësojë për t'i pajtuar ata

---

68 Muhtesar fil ibadat, f. 214.

69 Muhtesar fil ibadat, f. 214.

70 El-Mevsuatu el-fikhije, vëllimi 23, f. 321; Muhtesar fil ibadat, f. 214.



ose për t'i ndaluar nga vrasja.

Ai që ka borxhe personale, për nevojat e tij jetësore.

**7. Në rrugën e Allahut.** Sipas shumicës së dijetarëve në këtë kategori hyjnë vetëm gjërat që kanë të bëjnë me luftën në rrugën e Allahut.

Por, disa dijetarë këtu i fusin edhe gjërat e tjera që përfshihen në këtë term, siç është kërkimi i diturisë.

Ndërkaq, ndërtimi i xhamive, rregullimi i rrugëve apo urave, nuk është lejohet të bëhet me zekat, sepse këto gjëra nuk janë përmendur në ajetin fisnik.<sup>71</sup>

**8. Për udhëtarin e mbetur rrugëve.** Këtij i jepet aq sa t'i mjaftojë për t'u kthyer në vendin e tij ose për të arritur në vendin që ia ka mësyre.

Në lidhje me kategoritë e lartpërmendura, janë disa çështje që nuk janë përmendur direkt në ajetin fisnik, mirëpo dijetarët kanë folur për to:

## **A lejohet të jepet për nxënësin e dijes?**

Dijetarët e fikhut janë të një mendimi se është e lejuar që zekati t'i jepet nxënësit të dijes. Këtë e gjejmë të qartë te hanefitë, shafitë dhe hanbelitë, por edhe medhhebi maliki

---

71 El-Mungni, vëllimi 4, f. 125.

aludon në këtë. Dijetarët e fikhut e kanë lejuar këtë vetëm për nxënësin e shkencave fetare. Po ashtu, shumica e dijetarëve kushtëzojnë që nxënësi të jetë i varfër.<sup>72</sup>

## **A lejohet të jepet për shërim?**

Nëse i sëmuri është i varfër dhe nuk ka mundësi që të shërohet me të ardhurat e tij, atëherë, sipas një grupi dijetarësh bashkëkohorë, lejohet që të shërohet me paratë e zekatit, mirëpo kjo gjë është e lejuar nëse përbushen tri kushte:

1. Pamundësia që shërimi të bëhet falas,
2. Shërimi të jetë në gjërat e domosdoshme, e jo në ndërhyrje estetike a të ngjashme,
3. Shpenzimet të jenë vetëm sa për t'i mjaftuar të sëmurit, pa shpenzime shtesë.<sup>73</sup>

## **A lejohet të jepet për shtëpi apo banesë?**

Kjo çështje kthehet tek ajo se, sa duhet të jetë sasia që i jepet të varfrit? Dijetarët kanë dhënë tri mendime:

1. Dijetarët hanbeli dhe maliki thonë: I jepet aq sa i

72 Hashijetu Ibn Abidin, vëllimi 3, f. 289; Meusuatu fikhijetu, vëllimi 28, f. 336.

73 Fikhu nevazil fil ibadat, f. 209.

mjafton për një vit, për shpenzimet e domosdoshme, siç janë: ushqimi, pija, qiraja e shtëpisë, mjetet e kuzhinës etj.

2. Dijetarët shafi thonë: I jepet aq sa i duhet për tërë jetën.
3. Dijetarët hanefi thonë: Nëse është një person, atëherë i jepet vetëm aq sa ta arrijë nisabin, e, nëse janë disa anëtarë të një familjeje, atëherë secilit prej tyre i jepet aq sa ta arrijë nisabin, e jo përtej vlerës së nisabit.

Një pjesë e dijetarëve bashkëkohorë e kanë zgjedhur mendimin e parë si më të saktin, sepse zekati obligohet për çdo vit, andaj të varfrit i jepet aq sa i mjafton për një vit. Po ashtu i Dërguari ﷺ ua siguronte familjes së tij ushqimin për një vit.<sup>74</sup> Në anën tjetër, nëse disa të varfërve u blihet shtëpi apo banesë, ndodh që një pjesë e madhe e të varfërve të privohen prej marrjes së ndihmave të zekatit, pasi që zekati është përqendruar vetëm në disa persona, ngase çmimi i shtëpive apo banesave është tejet i lartë.

Në bazë të këtij mendimi, themi se nuk është e lejuar që të blihet shtëpi apo banesë me para të zekatit, porse të varfrit duhet t'i jepen paratë që ta paguajë qiranë për një vit.

---

74 Shënon Buhariu, numër 5357 dhe Muslimi, numër 1757.

Nëse një person ka blerë shtëpi apo banesë, mirëpo ka marrë borxhe për këtë, atëherë lejohet t'i jepet atij prej zekatit, ngase është borxhli.<sup>75</sup>

### ***A lejohet të jepet për martesë?***

Nëse i varfri nuk ka mundësi të martohet, atëherë është e lejuar që për martesë t'i jepet prej zekatit, por pa e tepruar në shpenzime, thjesht duke ia siguruar nevojat elementare që i duhen për martesë.<sup>76</sup>

### ***A lejohet të jepet për jetimët?***

Jetimët nuk përfshihen në kategoritë që i ka përmendur Allahu i Madhëruar se lejohet t'u jepet zekati, mirëpo shikohet se a hyjnë në ndonjërin prej tetë kategorive apo jo, për shembull: a janë të varfër, a janë nevojtarë, a janë borxhlinj etj. Nëse po, atëherë u jepet prej zekatit. Mirëpo, jo për shkak të kriterit që janë jetimë, por që janë të varfër... etj.

### **A lejohet t'u jepet familjarëve?**

1. Zekati nuk lejohet t'u jepet prindërve e as gjyshërve, si dhe nuk lejohet t'u jepet fëmijëve e as nipave.

75 El-Mebсут, Serahsi, f. 293; El-Mevsuatu el-fikhije, vëllimi 23, f. 316; Fikhu nevazil fil ibadat, Mushejkih, f. 206, i cili e përkrah mendimin e parë.

76 Nevazil ez-zekat, Abdullah el Gufeji, f. 364.

2. Ndërkaq, atyre që nuk kanë lidhje trashëgimore me atë që e jep zekatin, është e lejuar t'u jepet zekati, siç janë: daja, halla, tezja etj.<sup>77</sup>
3. Dijetarët hanefi e konsiderojnë të lejuar që t'i jepet vëllait ose motrës.
4. Një pjesë tjetër e dijetarëve thonë: Nëse e ka obligim që të shpenzojë për të, nuk i lejohet që t'ia japë zekatin, e, nëse nuk e ka obligim, atëherë i lejohet që t'ia japë zekatin.<sup>78</sup>
5. Sipas konsensusit të dijetarëve, burri nuk bën që t'i japë zekatin gruas së tij, sepse ai e ka obligim që të shpenzojë për të dhe ta mbajë atë.<sup>79</sup>
6. Gruas i lejohet që zekatin t'ia japë burrit të vet, ngase Zejnebja, gruaja e Abdullah ibn Mesudit, dhe një grua tjetër e kishin porositur Bilalin që ta pyeste të Dërguarin ﷺ: “A pranohet që zekati të jepet për burrin dhe për disa jetimë që ishin nën përkujdesjen e saj? Ai i ishte përgjigjur: “Po, ajo ka dy (herë) shpërblime: shpërblimin e afërsisë dhe atë të zekatit.”<sup>80</sup>

Kësisoj mendojnë dy nxënësit e Ebu Hanifes. Ndërkaq,

---

77 El-Mugni, vëllimi 4, f. 98.

78 El-Mebsut, Serahsi, f. 292; El-Mevsuatu el-fikhije, vëllimi 23, f. 326.

79 El-Mugni, vëllimi 4, f. 100.

80 Shënon Buhariu, numër 1466 dhe Muslimi, numër 1000.

Ebu Hanife mbron mendimin se nuk lejohet që gruaja t'ia japë zekatin burrit të saj, ngase ajo pasuri prapëseprapë i kthehet asaj.<sup>81</sup>

### ***A lejohet të jepet para kohe, gjegjësisht para se të kalojë një vit hënor?***

Shumica e dijetarëve hanefi, shafi dhe hanbeli<sup>82</sup> janë të mendimit se është e lejuar që zekati të nxirret para kohe. Argument për këtë kanë hadithin e Abasit, i cili i kërkoi leje të Dërguarit ﷺ që ta shpejtojë (ta japë) zekatin para se të obligohet, gjë të cilën ai ia lejoi.<sup>83</sup>

### ***A lejohet të vonohet dhënia e zekatit?***

Shumica e dijetarëve janë të mendimit se zekati duhet të jepet menjëherë pasi të bëhet obligim (sapo të kalojë një vit hënor) dhe se nuk lejohet të vonohet nxjerrja e tij, nëse ka mundësi për ta dhënë dhe nëse nuk frikësohet se do të dëmtohet me dhënien e tij. Kjo, se urdhri për ta dhënë zekatin nënkupton kryerjen e menjëhershme të tij, e jo që të vonohet. Në anën tjetër, zekati është hak i të varfërve, e, nëse ua vonojmë, vetëm se i kemi privuar prej hakut të

81 El-Mebsut, Serahsi, f. 292; El-Mevsuatu el-fikhije, vëllimi 23, f. 327.

82 El-Mebsut, Serahsi, f. 262; El-Mugni, vëllimi 4, f. 79.

83 Ebu Davudi, numër 1624; Tirmidhiu, numër 678; Ibn Maxhe, numër 1795, porse imam Ahmedi dhe Ebu Davudi këtë hadith e konsiderojnë të dobët.

tyre.<sup>84</sup>

Disa dijetarë e kanë lejuar shtyrjen e dhënies së zekatit nëse ka arsye të shëndoshë, për shembull: nëse një person duhet ta japë zekatin më datë 1 Ramazan, mirëpo paratë i ka të shpërndara te huamarrësit e tij, atëherë personit në fjalë i lejohet të presë ca ditë, derisa ta mbledhë shumën që e ka për obligim për ta dhënë.

## **Në cilin muaj është më së miri të jepet zekati?**

Fetarisht nuk është caktuar cili muaj është më i vlefshmi për ta dhënë zekatin, ngase zekati duhet dhënë posa të kalojë një vit pas arritjes së nisabit.

Në shumë vende praktikohet që të jepet në Ramazan, për shkak se është muaj i bekuar dhe se i Dërguari ﷺ në këtë muaj ka qenë më bujar. Kjo gjë nuk ka të keqe, mirëpo, sikur të jepej edhe muajve të tjerë, do të ishte më e përshtatshme për të varfrit, ngase ata kryesisht marrin në Ramazan, porse jashtë tij mbesin keq.<sup>85</sup>

---

84 El-Mevsuatu el-fikhije, vëllimi 23, f. 294.

85 Esh-Sherh el-Mumtië, Uthejmini, vëllimi 6, f. 189 dhe islamqa.info, numër, 8400.

## **A lejohet të nxirret jashtë vendit?**

Shumica e dijetarëve janë të mendimit se, nëse zekatin e dërgon jashtë vendbanimit në gjatësi ku lejohet shkurtimi i namazit, atëherë pranohet.<sup>86</sup>

Dijetarët hanefi thonë se është mekruh (e urryer), sepse kemi të bëjmë me hakun e fqinjit, porse është e pranuar, ngase, megjithatë, u jepet të varfërve. Mirëpo, nëse nxirret jashtë vendit te të afërmit e tij ose te dikush që është më nevojtar sesa vendasit e tij, atëherë nuk është mekruh.

Ndërkaq, dijetarët hanbeli e ndalojnë një gjë të tillë.<sup>87</sup>

## **A i lejohet huadhënësit që t'ia fshijë borxhin borxhliut të tij, në mënyrë që atë ta llogarisë zekat?**

Pjesa dërrmuese e dijetarëve e konsiderojnë të ndaluar që huadhënësi, në vend se ta nxjerrë zekatin, t'ia fshijë borxhin borxhliut të tij me qëllim që këtë ta llogarisë dhënie të zekatit. Kjo, se zekati është hak i Allahut, andaj nuk bën që ta japë, e ky të përfitojë prej tij apo që t'i lahet borxhi.<sup>88</sup>

Po ashtu, zekati duhet të jepet, e ai që e meriton, duhet

86 El-Mugni, vëllimi 4, f. 131.

87 Hashijtu ibn Abdidin, vëllimi 3, f. 304, El-Mebsut, f. 264; El-Lubab, vëllimi 1, f. 126.

88 El-Mevsuatu el-fikhije, vëllimi 23, f. 300.



ta marrë atë, e nuk lejohet vetëm të anulohet borxhi, pa dhënie dhe pa marrje.

## **A e pengon borxhi zekatin?**

Në këtë rast kemi të bëjmë me dy palë: huadhënësin dhe huamarrësin, ku për secilën ka dispozitë në vete:

**1. Huadhënësi:** Sa i përket huadhënësit, se a duhet ta japë zekatin apo jo, kemi dy mendime të dijetarëve:

Mendimi i parë: Nuk e ka obligim ta japë zekatin për pasurinë që e ka dhënë për borxh, sepse është gjë që nuk zhvillohet.

Mendimi i dytë: Bëjnë dallimin mes borxhit që shpreson se do t'i kthehet dhe borxhit për të cilin nuk shpreson se do t'i kthehet.

a. Për borxhin që shpreson se do t'i kthehet, të cilin ia ka dhënë atij që ka mundësi t'ia kthejë dhe është besnik në kthimin e borxheve, obligohet ta japë zekatin.

Disa kanë thënë: Zekati jepet pasi t'i kthehet borxhi. Këtë mendim e ndajnë dijetarët hanefi dhe hanbeli.

Disa të tjerë kanë thënë: E jep kur t'i vijë koha e zekatit, edhe nëse huamarrësi nuk ia ka kthyer borxhin, ngase afati i borxhit ende nuk është përmbushur. Këtë mendim

e kanë Shafiu dhe Ebu Ubejdi.

Për shembull: një person posedon pasuri prej 7000 eurosh, kurse një shumë prej 2000 eurosh ia ka dhënë borxh një shoku, i cili ka mundësi t’ia kthejë dhe është besnik në kthimin e borxhit. Atëherë themi se pronari i kësaj pasurie, pasi të kalojë një vit hënor, duhet ta japë zekatin për gjithsej 9000 euro, sepse këtë shumë prej 2000 eurosh e ka të sigurt. Pra,  $9000 : 40 = 225$  euro.

b. Për borxhin që nuk shpreson se do t’i kthehet, të cilin ia ka dhënë atij që nuk ka mundësi t’ia kthejë ose mohon se i ka marrë borxh, ose e vonon atë pa arsye, nuk obligohet ta japë zekatin, sepse ajo pasuri llogaritet sikurse të jetë e humbur dhe se nuk është nën pronësinë e pronarit (huadhënësit). Këtë mendim e kanë Shafiu dhe dijetarët hanefi.

Disa kanë thënë: Kurdo që t’i kthehet ai borxh, duhet ta japë zekatin për të gjitha vitet e kaluara. I këtij mendimi është Shafiu dhe Ahmedi.

Ndërkaq, Maliku është i mendimit se duhet ta japë vetëm për një vit.<sup>89</sup>

## 2. **Huamarrësi:** Sa i përket huamarrësit, dijetarët kanë bërë dallimin mes:

89 El-Mebсут, Serahsi, f. 274; El-Mevsuatu el-fikhije, vëllimi 23, f. 238.

a. Atij që merr borxh për nevoja të domosdoshme personale.

Në këtë rast, shumica e dijetarëve nuk e obligojnë dhënien e zekatit, sepse, ai që posedon, ta zëmë, 1000 euro, por të gjitha i ka borxh, nuk llogaritet i pasur.<sup>90</sup>

Argument i këtij mendimi është fjala e Othmanit (Allahu qoftë i kënaqur me të), i cili ka thënë: “Ky është muaji i zekatit tuaj. Ai që ka borxh, fillimisht le ta paguajë atë, pastaj le ta japë zekatin e asaj që ka i mbetur.”<sup>91</sup>

Pra, i jep përparësi larjes së borxheve që ka, më pas, nëse i mbesin para që arrijnë vlerën e nisabit, e jep zekatin e tyre. Për shembull: nëse një person posedon një shumë prej 2000 eurosh, porse është detyruar të marrë edhe një borxh prej 2500 eurosh për nevoja shtëpiake, në këtë rast themi se ky person nuk duhet të japë zekat për këto 2000 euro të tij, sepse, ç’është e vërteta, personi në fjalë është në minus, për shkak të borxhit që ka.

b. Atij që merr borxh për tregti ose për zhvillim të prodhimitarisë. Në këtë rast duhet të japë zekatin e pasurisë, sepse këto borxhe nuk janë të domosdoshme për nevojat elementare të njeriut. Për shembull, nëse një

---

90 Bedaius-senai, Alaudin el Kesani, vëllimi 2, f. 6, El-Mevsuatu el-fikhije, vëllimi 23, f. 245.

91 El-Muveta, numër 873; Musanef Abdurrezak, numër 7086; Musanef Ibn Ebi Shejbe, numër 10555, me zinxhir të saktë.

person merr borxh në vlerë prej 50000 eurosh, ndërkohë posedon biznesin në vlerë prej 40000 eurosh, atëherë ky person e ka për obligim ta nxjerrë zekatin e këtyre parave të tij, pra të 40000 eurove, kurse borxhi i marrë nuk e pengon obligimin që e ka në zekat.<sup>92</sup>

Për ata që kanë mallra në shitje, a është e lejuar që malli të jepet zekat, e jo paratë?

Shumica e dijetarëve maliki e hanbeli dhe, sipas një transmetimi, imam Shafiu, nuk e konsiderojnë të lejuar që zekati i mallrave tregtare të nxirret prej mallrave, por thonë se duhet të jepet (shumë parash) në vlerë të tyre.

Dijetarët hanefi dhe, sipas një transmetimi tjetër, Shafiu e konsiderojnë të lejuar që për zekat të jepen qoftë mallrat, qoftë vlera e tyre.<sup>93</sup>

Mendimin e dytë e përkrahin Ibn Tejmije dhe disa dijetarë bashkëkohorë, si: Ibn Bazi, Muhamed Munexhidi etj. Mbase ky mendim është më i përshtatshëm në rastin kur bizneset kanë mallra që mund t'i japin për zekat, porse nuk kanë para në vlerën që duhet ta nxjerrin.<sup>94</sup>

Dr. Jusuf Kardavi e mbron mendimin e parë, porse mendimin e dytë e lejon në rast se i varfri ka nevojë për

92 Fikhu en-nevazil fil ibadat, Mushejkijh, f. 232.

93 Bedaius-senai, vëllimi 2, f. 21; El-Mevsuatu fikhije, vëllimi 23, f. 276.

94 Fetava ibn Tejmije, vëllimi 5, f. 371, Islamqa.info, numër, 138314.

këtë lloj malli.<sup>95</sup>

## **A është e lejuar që me paratë e zekatit të blihen gjëra ushqimore apo diç tjetër, e t'i jepen të varfrit, sepse kjo është më e dobishme për të?**

Shumica e dijetarëve maliki, shafi dhe hanbeli nuk e konsiderojnë të lejuar që zekati të jepet jashtë llojit të vet. Pra, nëse është në para, duhet dhënë para, e, nëse është në kafshë, duhet dhënë kafshë etj.

Dijetarët hanefi, imam Buhariu etj., e konsiderojnë të lejuar që, për llojin e pasurisë që duhet dhënë zekat, të jepet prej një lloji tjetër. Argument për këtë e kanë fjalën e Muadh ibn Xhebelit, i cili u kishte thënë banorëve të Jemenit: “Për zekat, në vend të elbit dhe misrit, më sillni mallra prej rrobave hamis (rrobë e shkurtër me vija) dhe prej atyre që vishen. Kjo është më e lehtë për ju dhe më e mirë për shokët e të Dërguarit ﷺ në Medinë.”<sup>96</sup>

Ibn Tejmije e lejon këtë vetëm në rast nevojë, kurse në rrethana të zakonshme nuk e lejon. Këtë mendim e zgjedh

---

95 Fikhu zekat, f. 338.

96 Buhariu “talikan” (pa zinxhir të plotë), f. 230, kapitulli: Zekati, nënkapitulli 33; Sunen Darukutni, numër 1930; Bejhekiu në Sunenel-Kubra, numër 7372. Darukutni thotë se në zinxhirin e tij ka shkëputje.

dijetari Ahmed Halil.<sup>97</sup>

## ***A duhet t'i bëhet me dije të varfrit se kjo pasuri është zekat?***

Personi që dëshiron t'ia japë zekatin një të varfri, nuk ka nevojë që t'i tregojë se është zekat. Madje, me gjasë, një gjë e tillë e lëndon atë, andaj ia jap pa i treguar se është zekat.<sup>98</sup>

## **Çka nëse zekati i jepet personit të gabuar?**

Në këtë çështje kemi mendime të ndryshme se a i pranohet apo jo, mirëpo ajo që është më e zgjedhur është mendimi i imam Ebu Hanifes dhe nxënësit të tij, Muhamed ibn Hasenit, sipas të cilëve, nëse personi që ka për ta dhënë zekatin, ia jap një personi për të cilin mendon se është i varfër, mirëpo, pasi ia ka dhënë, e kupton se ai paska qenë i pasur, atëherë nuk ka nevojë që prapë ta japë zekatin, sepse ai është munduar dhe është përpjekur ta gjejë të varfrin.<sup>99</sup>

Argument për këtë kemi hadithin e Man ibn Jezidit (Allahu qoftë i kënaqur me ta), i cili rrëfen: "... Babai im, Jezidi, nxori disa dinarë për t'i dhënë lëmoshë dhe i la te një person në

97 Bedaius-senai, vëllimi 2, f. 21; Sahih el Buhari f. 237, kapitulli: Zekati, nënkaptulli 57; Ahmed Halil, artikulli: Blerja e ushqimeve për të varfrit, në vend se t'u jepen para, almoslim.net.

98 El-Mexhmuë, Neveviu, vëllimi 6, f. 233; El-Mevsuatu fikhije, vëllimi 23, f. 302

99 El-Lubab fi sherh el-kitab, vëllimi 1, f. 12 dhe El-Mevsuatu fikhije, vëllimi 23, f. 333.

xhami. Unë shkova dhe i mora ato (prej atij personi), pastaj shkova tek ai (babai i vet, Jezidi), i cili më tha: “Betohem në Allahun se ty nuk të kisha për qëllim.” Atëherë unë iu ankova të Dërguarit të Allahut ﷺ, i cili në atë rast më tha: *“Ti ke atë që ke pasur për qëllim, o Jezid (d.m.th. shpërblimin), kurse ti ke atë që ke marrë, o Man (d.m.th. paratë).”*<sup>100</sup>

---

100 Buhariu, numër 1422.

## ***Përfundim***

Falënderimi dhe lavdërimi i takon Allahut të Madhëruar, i Cili mundësoi përfundimin e këtij studimi të shkurtër, përmes të cilit lexuesi, përmbledhtas, do të gjejë dispozitat e zekatit. Megjithatë, unë kam disa rekomandime përkitazi me këtë studim:

Lexuesi i dispozitave të zekatit duhet ta lexojë këtë kapitull më shumë se një herë, ashtu që ta ketë më të lehtë kuptimin dhe perceptimin e tij.

Po ashtu ky lexim duhet të jetë i shoqëruar me mësimin pranë një hoxhe që e njeh këtë kapitull dhe është në gjendje ta sqarojë atë.

Lexuesi i kapitullit të zekatit, si dhe i kapitujve të tjerë të fikhut, duhet të ketë gjoks të gjerë karshi mendimeve divergjente të dijetarëve që i has e të mos ketë ngurtësi, si pasojë e së cilës të mos pranojë asnjë mendim tjetër. Përkundrazi, duhet të mundohemi ta gjejmë mendimin më të saktë, që është më afër argumentit, por jo duke ofenduar mendimin tjetër, sepse edhe tjetri ka argumentet përkatëse.

Nëse në ndonjë dispozitë të fikhut kemi dy ose më shumë mendime, mirëpo njërin mendim e kanë shumica e dijetarëve, atëherë ky mendim duhet çmuar dhe duhet marrë parasysh më shumë se mendimi që është i izoluar.



Kjo, se, të gabojnë disa dijetarë, është më pak e mundshme se të gabojë vetëm një.

## *Literatura*

Hafidh Ibn Rexheb el Hanbeli, Ahkam el-havatim, viti 1985, Dar el-Kutub el-ilmije.

Alaudin el Kesani, Bedaius-senai, viti 1986, Dar el-Kutub el-ilmije.

Ebu Ubejd Kasim ibn Selam el Heravi, El-Emval, Dar el-Fikr.  
Mexhdudin el Fejruz Abadi, El-Kamus el-muhit, viti 2005, Muesesetu er-Risale.

Abdulgani el Mejdani, El-Lubab fi sherh el-Kitab, viti 1998, Darul-Marife.

Ebu Bekër Muhamed ibn Ahmed es Serahsi, El-Mebsut, viti 2009, Bejtul eftar ed-deulije.

El-Mevsuatu el-fikhijetu el-kuvejtije, viti 1427 h, Dar es-Selasil.

Abdulkerim Zejdani, El-Mufesal fi ahkam el-mer'eti, viti 2000, Muesestu er-Risale.

Muvefak Ibn Kudame el Makdesi, El-Mugni, viti 2007, Dar Alemul-Kutub.

Abdullah ibn Mahmud el Musali, El-Muhtar lil-fetva, viti 2012, Dar el-Beshair el-islamije.

Halid el Mushejkih, El-Muhtesar fil-ibadat, viti 2013, Mektebetu er-Rushd.

Muhamed ibn Ahmed el Kurtubi, El-Xhamië li ahkam el-Kuran, viti 2007, Darul Kitab el-arabij.

Ali ibn Muhamed el Xhurxhani, Et-Tarifaf, viti 1983, Dar el-Kutub el-ilmije.

Tekijudin ibn Tejmije, Fetava, viti 1987, Dar el-Kutub el-ilmije.

Jusuf Kardavi, Fikhu zekat, viti 1993, Muesetu er-Risaleh.

Muhamed Salih el Uthejmini, Fikhul-ibadat, viti 2004, Medar el-vatan.

Halid el Mushejkih, Fikhun-nevazil fil-ibadat, viti 2013, Mektebetu er-Rushd.

Muhamed Emin ibn Omer Abidini, Hashijetu ibn Abidin, viti 2003, Dar Alemul-kutub.

Xhemaludin Ibn Mendhuri, Lisanul-arab, viti 1414 h, Dar Sadir.

Abdullah el Feuzani, Minhatul-al-lam, viti 2012, Dar Ibnul Xheuzi.

Abdurrezak ibn Hamam es Sanani, Musanef Abdurrezak, viti 1403, El-Mexhliis el-ilmi, Indi.

Ebu Bekër Ibn Ebu Shejbe, Musanef, viti 1409 h., Mektebetu er-Rushd.

Malik ibn Enesi, El-Muveta, vitit 1985, Dar Ihja et-turath

el-arabij.

Abdullah el Gufejli, Nevazil ez-zekat, viti 2008, Bank Al-bilad, Dar el-iman.

Muhamed ibn Ismail el Buhari, Sahih el Buhari, viti 2011, Tuvejik lin-neshri vet-tevzi.

Muslim ibn Haxhaxhi, Sahih Muslim, Dar Ihja et-turath el-arabij.

Ali ibn Omeri, Sunen Darekutnij, viti 2004, Muesesetu er-Risale.

Sulejman ibn el Eshathi, Sunen Ebi Davud, El-Mektebe el-asrije.

Muhamed ibn Jezidi, Sunen Ibn Maxhe, Dar Ihja el-kutub el-arabije.

Ahmed ibn Shuajbi, Sunen Nesai, viti 1986, Mekteb el-metbuat el-islamije.

Muhamed ibn Isa, Sunen Tirmidhi, viti 1998, Dar el-Garb el-islamij.

Abdullah el Xhibrini, Sherh umdetil fikh, viti 1429 h., Kursi el emir Sultan ibn Abdulaziz lid-diraset el-islamije el-muasira.

Almoslim.net

Islamqa.info



## Përmbajtja

Parathënie .....	3
Kuptimi i fjalës “Zekat” .....	4
Rëndësia .....	6
Kushtet e zekatit.....	8
Zekati i arit dhe argjendit .....	11
Zekati i stolive .....	19
Zekati i mallrave tregtare .....	21
Fabrikat .....	24
Zekati i bagëtive .....	27
Zekati i drithërave dhe i frutave apo kokrrave .....	32
Sasia e nxjerrjes së zekatit.....	34
Zekati i mjaltit.....	36
Kategoritë të cilave u jepet zekati.....	37
A lejohet të jepet për nxënësin e dijes? .....	40
A lejohet të jepet për shërim?.....	41
A lejohet të jepet për shtëpi apo banesë? .....	41
A lejohet të jepet për martesë? .....	43
A lejohet të jepet për jetimët? .....	43
A lejohet t’u jepet familjarëve? .....	43

A lejohet të jepet para kohe, gjegjësisht para se të kalojë një vit hënor? .....	45
A lejohet të vonohet dhënia e zekatit? .....	45
Në cilin muaj është më së miri të jepet zekati? .....	46
A lejohet të nxirret jashtë vendit? .....	47
A i lejohet huadhënësit që t’ia fshijë borxhin borxhliut të tij, në mënyrë që atë ta llogarisë zekat? .....	47
A e pengon borxhi zekatin? .....	48
A është e lejuar që me paratë e zekatit të blihen gjëra ushqimore apo diç tjetër, e t’i jepen të varfrit, sepse kjo është më e dobishme për të?.....	52
A duhet t’i bëhet me dije të varfrit se kjo pasuri është zekat?.....	53
Çka nëse zekati i jepet personit të gabuar?.....	53
Përfundim.....	55
Literatura.....	57





